



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri

PREZENCA E OSBE-SË NË SHQIPËRI

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri punon në partneritet me vendin pritës për të forcuar institucionet kryesore shtetërore, për të konsoliduar një sistem demokratik kontrolli dhe ekuilibri, si dhe për të forcuar dialogun midis palëve për të rritur besimin te këto institucione.

Pamje e përgjithshme

Për përmbushjen e qëllimit të saj kryesor, Prezenca fokusohet veçanërisht te reforma legjislative dhe gjyqësore, ku përfshihet edhe reforma e pronave; reforma territoriale administrative; reforma zgjedhore; përmirësimi i kapaciteteve të Kuvendit; veprimtaritë kundër trafikimit dhe korrupsionit; hartimi i ligjeve dhe rregulloreve të efektshme për një media të pavarur; nxitja e një qeverisjeje të mirë dhe menaxhimi i projekteve që synojnë forcimin e shoqërisë civile; si dhe ndihma që i jepet policisë në bashkëpunimin me partnerët e saj ndërkombëtarë.

Si punojmë ne?

Prezenca e OSBE-së drejtohet nga Kryetari i Prezencës, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për të gjitha çështjet që kanë lidhje me politikën dhe funksionimin e saj. Veprimtaritë tematike të Prezencës zbatohen nga katër departamente: Demokratizimi; Shteti i së Drejtës dhe të Drejtat e Njeriut; Mirëqeverisja në Çështjet Ekonomike dhe Mjedisore; dhe Departamenti për Bashkëpunim në Çështjet e Sigurimit. Një zyrë për bashkërendimin e zyrave të projekteve vepron si urë lidhëse midis selisë qendrore të Prezencës në Tiranë dhe katër zyrave të saj të projekteve (Shkodër, Kukës, Vlorë dhe Gjirokastrë). Ajo bashkërendon veprimtaritë e projekteve jashtë Tiranës dhe ruan kontaktet me partnerët kryesorë vendas.

Programet e Prezencës

Demokratizimi

Synimi kryesor është ofrimi i ndihmës në lidhje me reformën zgjedhore dhe atë të regjistrimit të gjendjes civile; përkatësinë gjinore, shoqërinë civile, median dhe reformën parlamentare.

Reforma zgjedhore

Në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), institucionet shtetërore, partitë politike dhe shoqëria civile janë ndihmuar për të zhvilluar më tej kuadrin ligjor për zgjedhjet. Është mbështetur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për t'i përgatitur zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it duke rritur kapacitetet e tij trajnuese dhe duke ofruar edhe ndihma të tjera të karakterit teknik. Gjithashtu, Prezenca ka botuar dhe u ka shpërndarë aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë kopje të Kodit të ri Zgjedhor.

Mbështetja për Kuvendin

Projekti në mbështetje të Kuvendit punon me komisionet parlamentare për forcimin e mëtejshëm të veprimtarive në lidhje me komunikimin me zgjedhësit; rritjen e transparencës së Kuvendit; modernizimin e kapaciteteve kërkimore të Kuvendit; modernizimin e bibliotekës dhe arkivës së Kuvendit; krijimin e një rrjeti të brendshëm kompjuterik dhe një baze të dhënash mbi legjislacionin; si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve të Kuvendit, përfshirë krijimin e një programi praktike mësimore për studentët. Projekti realizohet në bashkëpunim me projekte të ngjashme në misionet të tjera të OSBE-së dhe ka për qëllim të lehtësojë këmbimin e informacionit. Projekti financohet nga qeveria e Holandës.

Modernizimi i regjistrimit të gjendjes civile dhe sistemit të adresave

Me fonde të Komisionit Evropian, qeverisë i është dhënë ndihmë teknike për të krijuar një regjistrim modern të gjendjes civile, një sistem adresash, si dhe një sistem për mbrojtjen e të dhënave. Këto sisteme përmirësojnë punën e administratës publike dhe, si pasojë, edhe cilësinë e shërbimeve që i ofrohen publikut. Krijimi i një Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile siguroi bazën e listës së



zgjedhësve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 dhe të dhënat për kartat e identitetit. Ministrisë së Brendshme iu dha mbështetje në krijimin e strukturave të qëndrueshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe në gjetjen e zgjidhjeve për procedurat dhe programet kompjuterike në lidhje me menaxhimin e Regjistrit Kombëtar. Puna vazhdon me qeverinë qendrore dhe vendore për krijimin e një Regjistri elektronik Kombëtar Adresash. Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, vazhdon puna për rritjen e kapaciteteve të autoritetit të sapokrijuar të mbrojtjes së të dhënave për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve.

Shoqëria civile

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje mbështetet nëpërmjet lehtësimit të bashkëpunimit me aktorët shtetërorë si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive kombëtare dhe vendore. Me mbështetjen e OSBE/ODIHR-it, u mundësua konsultimi mbi një projektligj për Agjencinë shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Prezenca ka ndihmuar për krijimin e tre qendrave të zhvillimit të shoqërisë civile, të cilat tani punojnë në mënyrë të pavarur. Me fonde të qeverisë gjermane dhe në bashkëpunim me bashkinë e Korçës dhe Qendrën për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në këtë qytet, në bashki është krijuar një fond për zhvillimin e shoqërisë civile vendore për mbështetjen e OJQ-ve që operojnë në këtë rreth në kryerjen e veprimtarive të tyre qytetare.

Përkatësia gjinore

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale e Mundësive të Barabarta dhe me partnerët ndërkombëtarë, qeveria dhe OJQ-të vendore janë mbështetur në punën e tyre për nxitjen e barazisë gjinore dhe veçanërisht për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore. Si rrjedhojë e këtyre përpjekjeve, u miratua edhe një kuotë gjinore në Kodin Zgjedhor. Për të promovuar më tej kuotën gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në jetën publike, filloi një projekt tre-vjeçar për rritjen e rolit të grave në qeverisje, financuar nga qeveria holandeze dhe suedeze.

Zhvillimi i medias

Media vendase dhe institucionet përkatëse të saj janë ndihmuar për harmonizimin e legjislacionit dhe rregulloreve vendase të medias me standardet ndërkombëtare. Me fonde

të qeverisë austriake është mbështetur një proces i gjerë konsultimi për të ndihmuar në hartimin e një strategjie për dixhitalizimin e televizionit kombëtar. Veprimtaritë janë fokusuar te nxitja e pavarësisë së medias dhe liria e shprehjes, profesionalizmi i gazetarëve, si edhe te vetërregullimi dhe e drejta për informim. Një projekt i financiar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar në bashkëpunim me fondacionin Friedrich Ebert Stiftung nxit krijimin e një klubi për median shqiptare si një organ vetërregullues për gazetarët dhe pronarët e mediave. Në të gjitha veprimtaritë e medias, Prezenca punon ngushtë me Përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

SHTETI I SË DREJTËS DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Qëllimi kryesor është që të ndihmojnë vendin pritës në ndërtimin e një sistemi të shëndoshë ligjor. Përveç kësaj, Prezenca promovon respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe krijimin e funksionimit e institucioneve shtetërore bazuar në parimet e shtetit të së drejtës.

Reforma legjislativë

Sigurimi i ekspertizës ligjore dhe teknike për institucionet shtetërore është një ndër veprimtaritë kryesore. Ndihmë jepet, gjithashtu, edhe për përmirësimin e transparencës dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin legjislativ. Veprimtaritë e Prezencës ndihmojnë për të përcaktuar disa orientime për konsultimet me grupet e interesit dhe aktorë të tjerë të interesuar para miratimit të ligjeve, si dhe për të trajnuar shoqërinë civile në teknikat e komentimit mbi projektligje të ndryshme. Përveç kësaj, Prezenca ka dhënë komentet e saj mbi disa pjesë thelbësore të legjislacionit.

Reforma gjyqësore dhe zhvillimi i proceseve të drejta të gjykimit

Mbi sistemin ligjor kanë dalë disa raporte të rëndësishme, të cilat kanë dhënë edhe rekomandime për reforma dhe për mënyrën se si Prezenca mund të ndihmojë për zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve ligjore. Kanë nisur një sërë projektesh për përmirësimin e njohjes dhe zbatueshmërisë së standardeve të etikës në gjyqësor. Projekti i monitorimit të



gjkatave analizon disa gjyqe të çështjeve penale dhe civile. Kjo analizë bëhet si nga këndvështrimi i standardeve vendore, ashtu edhe nga këndvështrimi i standardeve ndërkombëtare për një gjykim të drejtë dhe është botuar në disa raporte periodike, të cilat përmbajnë edhe disa rekomandime për rritjen e efektshmërisë dhe transparencës. Gjithashtu, ofrohet trajnim për të rritur profesionalizmin e gjyqtarëve dhe për t'i njohur ata më shumë me standardet e një procesi të rregullt gjyqësor. Prezenca ka qenë aktive në nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative ndaj burgimit, duke punuar me Ministrinë e Drejtësisë për të zhvilluar legjislacionin dhe standardet e trajnimit për shërbimin e provës.

Të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut janë pjesë e qëllimeve të përgjithshme të mandatit të Prezencës. Veprimtaritë e projektit përfshijnë forcimin e të drejtave të minoriteteve të dobëta; mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve; përmirësimin e mbrojtjes së nëpunësve civilë; përmirësimin e kushteve të ambienteve të paraburgimit; si dhe zhvillimin e një mbrojtjeje sistematike të të miturve që bien në kontakt me sistemin ligjor. Ka nisur një projekt për rritjen e mundësisë së grave viktime të dhunës në familje për t'iu drejtuar drejtësisë dhe për të rritur ndërgjegjësimin rreth ligjit të dhunës në familje mes ushtruesve të profesioneve në fushën e drejtësisë dhe shoqërisë civile. Prezenca ka punuar me OJQ-të vendore për hartimin e legjislacionit kundër diskriminimit. Ajo do t'u ofrojë autoriteteve shqiptare ndihmë të mëtejshme për garantimin e zbatimit të plotë të tij.

QEVERISJA NË ÇËSHTJE EKONOMIKE DHE MJEDISORE

Qëllimi kryesor është mbështetja e qeverisë dhe e shoqërisë civile në lidhje me nismat për të nxitur qeverisjen e mirë dhe mirëqenien ekonomie dhe mjedisore; për të luftuar korrupsionin; për të mbështetur reformën e pronave; si dhe për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore.

Ekonomia dhe mjedisi

Për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të forcuar institucionet e dobëta që pengojnë zgjerimin ekonomik,

qeveria mbështetet për të zhvilluar më tej një kuadër institucional më efektiv, për të bashkërenduar, monitoruar dhe vënë në zbatim gjithë politikat kundër korrupsionit me aktorë të ndryshëm. Është lehtësuar zhvillimi i një dialogu më të gjerë midis qeverisë dhe sektorit privat për promovimin e aspekteve të përgjegjësisë së përbashkët shoqërore dhe mjedisore dhe partneriteteve të sektorit publik me atë privat për të përfshirë një gamë më të madhe institucionesh në rritjen e përputhshmërisë me konventat e rëndësishme ndërkombëtare.

Lufta kundër korrupsionit

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në fushën e reformës territoriale dhe strategjisë së qeverisë për decentralizimin është siguruar mbështetje për ngritjen e kapaciteteve gjatë aspekteve të nxitjes së qeverisjes së mirë, duke përfshirë transparencën, gjithëpërfshirjen, si dhe ofrimin e shërbimeve për publikun në nivel vendor. Përveç kësaj, qeveria mbështetet edhe në luftën e saj kundër korrupsionit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të aktorëve kombëtarë për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave, si dhe trajnimit të zyrtarëve të administratës shtetërore mbi kuadrin ligjor të konfliktit të interesave. Një projekt aktual synon forcimin e mëtejshëm të efektshmërisë së shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit në qeverinë vendore.

Reforma e pronave

Qeveria është ndihmuar në regjistrimin e pronës së paluajtshme, procesin e kthimit dhe kompensimit, si dhe në aspektet përkatëse të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje. Kjo përfshin ndihmën për agjencitë përgjegjëse për këto fusha të ndërlidhura të reformës së pronave. Ndihmë është ofruar edhe për mbylljen e regjistrimit fillestar të pronave të paluajtshme në zonat parësore bregdetare dhe për lëshimin e titujve të sigurt të pronësisë përmes ofrimit të ekspertizës në aspektet e përgjithshme dhe ligjore të reformës së pronave.

Reforma kundër trafikimit

Puna përqendrohet në: mbrojtjen e të drejtave të personave të trafikuar, zhvillimin e politikave për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe adresimin e të gjitha formave të shfrytëzimit. Për të mbështetur angazhimet e qeverisë për të përmirësuar identifikimin dhe mbrojtjen e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar, autoriteteve të zbatimit të ligjit,



komiteteve rajonale kundër trafikimit dhe inspektorateve të punës u është siguruar mbështetje e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar për çështje të trafikimit është rritur përmes mbështetjes së dhënë Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit në organizimin e takimeve me vendet fqinje për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar për mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit. Për trajtimin e punës së fëmijëve, si rezultat i bashkëpunimit me OJQ-në “Terre des Hommes” dhe me autoritetet vendore në Vlorë, është krijuar një njësi për mbrojtjen e fëmijëve.

Në bashkëpunim me OSBE/ODIHR-in, po zbatohet një projekt për të forcuar më tej mundësinë e personave të trafikuar për t’iu drejtuar drejtësisë dhe për të gëzuar të drejtat e tyre, duke monitoruar, duke ofruar ndihmë ligjore falas dhe duke rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat e njeriut. Mbrojtja e fëmijëve të rrugës që rrezikohen nga trafikimi apo shfrytëzimi mbështet përmes veprimtarive të ndryshme me komunitetet rome dhe egjiptiane.

Në bashkëpunim me OSCE/OCEEA-n, është mbështetur fuqizimi ekonomik i grave në veri të Shqipërisë. Prezenca ka mbështetur një partner zbatues vendor për të ofruar trajnime për formimin profesional dhe për njohuri mbi sipërmarrjet, shërbime këshillimore në fushën e biznesit, si dhe për të dhënë disa kredi të vogla. Nga kjo mundësi për të marrë kredi, kanë përfutur rreth 40 gra, të cilat i kanë përdorur paratë për të filluar një biznes ose për të zgjeruar biznese ekzistuese.

BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E SIGURISË

Prezenca i ka siguruar mbështetje Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kufirit dhe Emigracionit. Puna e Forumit të OSBE-së për Bashkëpunim në fushën e Sigurisë është mbështetur nga Prezenca në ofrimin e asistencës teknike Ministrisë së Mbrojtjes në përpjekjet e saj për të çmilitarizuar sasinë e tepërt të municioneve konvencionale.

Menaxhimi i integruar i kufirit

Për të ndihmuar autoritetet shtetërore në çështjet e menaxhimit të integruar të kufirit, Prezenca mbështet takimet ndërkufitare të bashkëpunimit, të cilat sjellin së bashku policitë e shteteve fqinje për të diskutuar çështje mbi kufirin dhe sigurinë. Për të përmirësuar sigurinë në kufi, janë siguruar pajisje të specializuara teknike, lexues për pasaportat biometrike dhe sisteme rezervë për furnizimin me energji elektrike.

Ndihma për policinë

Policisë i është siguruar asistencë teknike, e cila përfshin trajnimin e efektivëve të policisë për mënyrën e operimit të tyre gjatë proceseve zgjedhore, për përdorimin e metodave të përparuara të instruktimit të policisë, teknikat e hetimit të shërbimit të kontrollit të brendshëm, policimit demokratik dhe atij në komunitet, si dhe në fusha të luftës kundër krimit të organizuar.

Çmilitarizimi i municioneve të tepërta

Për të lehtësuar punën e Forumit të OSBE-së për Bashkëpunim në fushën e Sigurisë, Prezenca ka ndihmuar Ministrinë e Mbrojtjes në përpjekjet e saj për të çmilitarizuar municionet e tepërta konvencionale. Prezenca ka ndihmuar për eliminimin e të gjitha stoqeve të melanzhit (një përbërës i karburantit të lëngshëm për raketa) me mbështetjen financiare të qeverisë së Danimarkës, Suedisë, Finlandës dhe Greqisë.

FAKTE DHE SHIFRA

Përveç buxhetit bazë prej 3,296,200 eurosh, Prezenca administron edhe fonde jashtë këtij buxheti të siguruar nga shtetet anëtare të OSBE-së, të cilat në vitin 2010 arrijnë në 2,223,100 euro.

Personeli: 109 (personel ndërkombëtar 25; këshilltarë vendës 17; personel për shërbimet e përgjithshme 67).